



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:264635

Datë: 12.09.2024

Numri i dokumentit: 06153366

C.nr.4539/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Uran Zogaj, me bashkëpunëtoreshen profesionale H.D. në çështjen juridike kontestimore të paditëses L.Sh. nga Prizreni, me numër personal të cilën me autorizim e përfaqëson A.H. avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Mamushës – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën e përfaqëson Përfaqësuesi Ligjor Ç.N. me objekt të kontestit pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit, vlera e kontestit 370.99 euro, jashtë shqyrtimit kryesor, më datë 12.09.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditëses L.Sh. nga Prizreni.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Mamushës - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit, për periudhën kohore nga data 20.04.2022, deri me 20.11.2022, të ia kompensoj shumën prej 343.20 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (15.11.2023) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET e paditura, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditëses t'ia paguaj shumën prej 124.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

IV. REFUZOHET e pa bazuar, pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses, përtej shumës së gjykuar sikur në pikën II. të dispozitivit të aktgjykimit deri në shumën e kërkuar prej 370.99 euro, përkatësisht shuma prej 27.79 euro, në emër të pagesës mbi bazën e përqindjes së inflacionit.

A r s y e t i m

Paditësja L.Sh. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate me datë 02.12.2023, përmes të autorizuarit të saj, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Mamushës – Drejtoria Komunale e Arsimit, duke kërkuar nga gjykata që ta detyroj të paditurën për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit për periudhën kohore nga data 20.04.2022, deri më datën 20.11.2022, duke theksuar se paditësja është në marrëdhënie pune në SHFMU “Anadollu” në Mamushë dhe bazuar në nenin 35 par. 10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, është paraparë që për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë. Shuma për kompensimin sipas inflacionit e cila i takon paditësit është shuma në lartësi prej 370.99 euro. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur kërkesën e paditësit vullnetarisht, gjykatës i ka propozuar që të merr aktgjykim

dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Mamushës – Drejtoria Komunale e Arsimit, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 15.03.2024, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar. Ka theksuar se pretendimet e paditëses se i takon kompensimi i inflacionit është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sepse në këtë dispozitë shkruan qartë se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit-SBASHK-ut, ndërsa paditësi në padi nuk ka paraqitur asnjë provë të vetme se është anëtarë në këtë syndikatë. Paditësi ka ushtruar padi në gjykatë pa i përfunduar procedurat administrative sepse nuk ka bërë kërkesë në DKA për përmbushjen e këtyre të drejtave, me këtë rast paditësi nuk i ka shtjerrë të gjitha mjetet juridike në procedurë administrative. Tutje ka shtuar se Kontrata Kolektive nuk është nënshkruar nga Komuna e Mamushës, po kjo kontratë është nënshkruar nga Ministria e Arsimit dhe Sindikata MASHT, andaj si e tillë Komuna e Mamushës nuk ka ndarë vijën buxhetore për pagesën e beneficioneve të cilat rrjedhin nga Kontrata kolektive. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj në tërësi si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 398 dhe nenin 399 të LPK, gjeti se kërkesëpadija e paditëses është pjesërisht e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigje në padi, si dhe nga Kontrata e punës numër 035/15, të datës 01.09.2015, për paditësin e lëshuar nga e paditura, lista e pagave EM00057276, vërtetohet fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, në SHFMU “Anadollu” në Mamushë, në pozitën e mësimdhënëses së Gjuhës Shqipe.

Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës vërtetohet lartësia e pagës bazë e paditëses, e që është shuma prej 421.00 euro. Po ashtu gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura ia fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që *“Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së*

Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”, ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditëses i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë sipas përlllogaritjes së bërë në këtë mënyrë:

- Për periudhën 20.04.2022 deri me datë 20.11.2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6 %, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2022 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për muajin prill 2022 është 17.82 euro sipas llogaritjes ($421 * 11.6 \% = 48.83$, $48.83/30 = 1.62 * 11$ ditë = 17.82 euro), për muajin maj e deri në muajin tetor 2022, është 195.32 euro ($421 * 11.6 \% = 48.83 * 6$ muaj = 292.98 euro), si dhe periudha 20 ditë të muajit nëntor është 32.40 euro sipas llogaritjes ($48.83/30 = 1.62 * 20$ ditë = 32.40 euro) = $17.82 + 292.98 + 32.40 = 343.20$ euro).

Bazuar në të lartcekurat, gjykata duke iu referuar nenit 398 të LPK-së, ku parashihet që: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, ka vendosur si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia njohur pjesërisht paditëses kompensimin mbi bazën e përqindjes së inflacionit në pagën bazë të cilën e realizon paditësja dhe atë në shumën prej 343.20 euro, duke u bazuar pagën bazë të cilën e realizon paditësja e që është 421.00 euro, kjo sipas listës së pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe atë në kuptim të nenit 399 paragrafi 1 të LPK-së, ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija”*, duke ia refuzuar paditëses shumën prej 27.79 euro, në emër të pagesës mbi bazën e përqindjes së inflacionit. Duke u bazuar në listën e pagave me numër EM00057276, vërtetohet fakti se paga bazë të cilën e realizon paditësja është në lartësi prej 421.00 euro dhe jo 456.89 euro, sa e ka kërkuar paditësja, pasi që kjo shumë përfshinë në vete edhe shtesat në pagë që i realizon paditësja. Andaj mbi këtë bazë gjykata refuzoi të pabazuar kërkesën e paditëses sikurse në pikën nën IV të dispozitivit të aktgjykimit dhe atë duke e minusuar shumën e kërkuar në raport me pagën që paditësja e realizon.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (15.11.2023), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Sa i përket kundërshtimeve tjera të të paditurës dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453 par. 2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve,

Numri i lëndës: 2023:264635

Datë: 12.09.2024

Numri i dokumentit: 06153366

lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 104 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 20 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 124.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 398 dhe nenit 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.4539/2023, datë 12.09.2024

G j y q t a r i
Uran Zogaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.